

NJOFTIM
Nr. 4208, datë 24.5.2022

PËR PUBLIKIMIN E FTESËS PËR OFERTË PËR “PROJEKTIMIN, FINANÇIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN E DISA IMPIANTEVE EOLIKE TOKËSORE, SECILI ME NJË KAPACITET TË INSTALUAR MIDIS 10 DHE 75 mw (PËRFSHIRË), TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASA MBËSHTETËSE, ME VENDNDODHJE TË ZGJEDHUR NGA OFERTUESI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12.6.2018, “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të elektricitetit nga burimet e rinovueshme të diellit dhe të erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”, si dhe të urdhrit të ministrit nr. 336/1, datë 20.12.2019, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vendosur zbatimin e projektit për “Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen e disa impianteve eolike tokësore, secili me një kapacitet të instaluar midis 10 dhe 75 mw (përfshirë), të cilët do të përfitojnë masa mbështetëse, me vendndodhje të zgjedhur nga ofertuesi në Republikën e Shqipërisë”.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
FTESË PËR OFERTË

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktues: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë, Adresa: rr. “Abdi Toptani”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri.

2. Emri dhe adresa e personit të kontaktit:

Z. Antonio Bushati, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

E-mail: antonio.bushati@infrastruktura.gov.al

3. Forma, objekti dhe lloji i kontraktimit: Përzgjedhja e projekteve për “Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen e disa impianteve eolike tokësore, secili me një kapacitet të instaluar midis 10 dhe 75 mw (përfshirë), të cilët do të përfitojnë masa mbështetëse, me vendndodhje të zgjedhur nga ofertuesi në Republikën e Shqipërisë”, (projekti).

Pjesëmarrja në këtë proces konkurrues lejohet vetëm për projekte me një kapacitet minimal prej 10 mw dhe kapacitet maksimal prej 75 mw. Nëpërmjet këtij procesi konkurrues MIE do të përzgjedhë projekte me një kapacitet të përgjithshëm prej 100 mw, të cilët do të përfitojnë masat mbështetëse që përshkruhen më poshtë. Autoriteti kontraktues më vonë mund të vendosë që të rrisë kapacitetin total të tenderuar deri në 150 mw.

4. Lloji i procesit konkurrues: Procedurë e hapur.

5. Vendndodhja e projektit: E zgjedhur nga ofertuesi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

6. Kohëzgjatja e marrëveshjes së zhvillimit të projektit: Fillon në datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes dhe përfundon 15 vjet pas datës së operimit tregtar (sipas specifikimeve të parashikuara në dokumentet e procesit konkurrues).

7. Marrëveshja e blerjes së energjisë elektrike: Do të nënshkruhet për të gjithë kapacitetin total të ofertuesit të përzgjedhur kundrejt çmimit të energjisë elektrike, për një afat që fillon në datën e hyrjes në fuqi dhe përfundon 15 vjet pas datës së operimit tregtar, duke përfshirë edhe rastin e konvertimit (d.m.th. marrëveshja për blerjen e energjisë elektrike e lidhur fizikisht do të konvertohet në një kontratë për diferencë të likuiduar financiarisht) (sipas specifikimeve të parashikuara në dokumentet e procesit konkurrues).

8. Afati për dorëzimin e aplikimeve për kualifikim: 13 qershor 2022, ora 18:00, ora e Evropës Qendrore.

Nëse aplikimi për kualifikim do të dorëzohet me postë, ajo do të quhet se është dorëzuar rregullisht në afatin e dorëzimit të aplikimeve për kualifikim nëse plotëson në mënyrë kumulative kushtet më poshtë:

- data që shënohet në zarf, konfirmuar nga vërtetimi postar duhet të jetë jo më vonë se afati për dorëzimin e aplikimeve për kualifikim (d.m.th. 13 qershor 2022, ora 18:00, ora e Evropës Qendrore);

- MIE merr aplikimin për kualifikim jo më vonë se data për hapjen e aplikimeve për kualifikim (d.m.th. 20 qershor 2022, ora 12:00, ora e Evropës Qendrore).

MIE do të lëshojë konfirmimin e marrjes së aplikimit për kualifikim, me datën dhe orën e marrjes. Aplikimet për kualifikim që dorëzohen dorazi pas afatit të dorëzimit apo aplikimet për kualifikim që dorëzohen me postë që nuk plotësojnë në mënyrë kumulative kushte e mësipërme nuk do të shqyrtohen. Ato do t'i kthehen ofertuesve potencialë pa u hapur.

9. Hapja e ofertave: 20 qershor 2022, ora 12:00, ora e Evropës Qendrore.

Informacioni i komunikuar përgjatë hapjes publike të aplikimeve për kualifikim të dorëzuara nëpërmjet mjeteve elektronike do t'u komunikohet, me kërkesë të tyre, të gjithë ofertuesve potencialë që kanë dorëzuar një aplikim për kualifikim.

10. Pranimi dhe vlerësimi i ofertës: Sipas përcaktimeve në dokumentet e procesit konkurrues.

Informacion shtesë mbi dokumentet e procesit konkurrues mund të gjeni në *website*-in e autoritetit kontraktues: <http://www.infrastruktura.gov.al>.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Viola Haxhiademi